



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GRAÇANICËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Graçanicës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Graçanicës (KG), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Graçanicës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Llogaritë e arkëtueshme ishin nënvlerësuar në RFV për vlerën prej 1,418,635€.
- B2 Ishin bërë keqklasifikime të shpenzimeve në kategoritë ekonomike të ndryshme në vlerë 399,054€, përfshirë pagesa për paga, investimet kapitale, mallra dhe shërbime që janë raportuar në kategori të gabuara buxhetore.
- B3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale nuk janë prezantuar saktë në PVF, si dhe stoqet ishin nënvlerësuar për 528,666€, për shkak të mos regjistrimit të tyre.
- B4 Detyrimet kontingjente të prezantuara në nenin 18 në RVF ishin të nënvlerësuar për 15,952€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Graçanicës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B5 Në katër (4) raste kontrata me çmime për njësi, vlera e shpenzuar e një kategorie të caktuar, ka tejkaluar vlerën e lejuar për shpenzim sipas peshimit.
- A1 Përdorim joadekuat i kontratave publike kornizë për punë me sasi indikative.
- A2 Në 16 raste në vlerë 510,389€, komuna nuk kishte respektuar hapat për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës.
- A3 Për 17 zyrtarë komunal nuk ka raporte të vijueshmërisë në punë për vitin 2024.
- A4 Mos harmonizimi i kontratave të punës/akt emërimeve sipas kërkesave ligjore.
- B6 Në 30 raste kemi vërejtur se stafi arsimor dhe shëndetësor nuk janë sistemuar në vendin e punës sipas kontratës.
- A5 Aplikimi i koeficientit jo në pajtueshmëri me ligjin për paga.
- A6 Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë.
- A7 Mungesë e dëshmive për llogaritë e arkëtueshme nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë në vlerë 24,300€.
- A8 Në tri (3) raste kishte vonesa në pagesën e obligimeve ndaj kontraktuesve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetarja e Komunës është përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetarja e Komunës është përgjegjëse edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetarja e Komunës është përgjegjëse për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Graçanicës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Graçanicës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Graçanicës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Graçanicës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Graçanicës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: keqklasifikim e shpenzimeve, mangësi në prokurim, dobësi në menaxhimin me të hyra, mangësi në lidhje me menaxhimin e pasurive dhe stoqeve, mangësi me prezantimin e llogarive të arkëtueshme dhe detyrimeve kontingjente, menaxhim jo të mirë të kontratave, vonesa në pagesën e faturave, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 18 rekomandime, prej tyre 11 janë rekomandime të reja, dhe shtatë (7) të përsëritura.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2024, ishin realizuar pagesa nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore në vlerë 754,526€, nga kjo vlerë për paga ishin paguar 26,721€, si dhe 727,805€, për shpronësim dhe për operator ekonomik. Sipas regjistrat të komunës borxhi kryesor ishte 740,144€, ndërsa 14,382€, ishin shpenzime të interesit dhe shpenzime tjera procedurale të gjykatës/përmbartimit.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Nënvlërësimi i llogarive të arkëtueshme në RFV

Gjetja

Neni 16 i Rregullores MF-nr.01/2017 për raportim vjetor financiar për organizata buxhetore përcakton "OB-të që mbledhin të hyra, janë të detyruara të mbajnë regjistra të plotë për shumatat e paarkëtuara".

Llogaritë e arkëtueshme ishin nënvlërësuar për 1,418,635€, si rrjedhojë e mos prezantimit të plotë të borxheve të paarkëtuara nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë nga vitet e mëparshme, por duke prezantuar vetëm ato për periudhën 2022-2024 në vlerë prej 666,460€. Përkundër faktit se kjo dukuri e përcjell komunën për vite radhazi dhe janë dhënë rekomandime për zbatim, nga ana e komunës nuk është marrë ndonjë veprim për raportim dhe shpalosje të saktë të këtyre llogarive.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme për përmirësimin e regjistrave të llogarive të arkëtueshme, raportimin e drejtë dhe shpalosjen e tyre në RVF.

Ndikimi

Mos prezantimi dhe shpalosja jo e saktë e llogarive të arkëtueshme ndikon në raportim jo të drejtë dhe të saktë të informatave financiare, respektivisht në nënvlërësimin e tyre në RVF.

Rekomandimi B1 Kryetarja duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme, në mënyrë që të përmirësohet procesi i menaxhimit, prezantimit të drejtë dhe shpalosjes së llogarive të arkëtueshme në RVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Keqklasifikim i shpenzimeve

Gjetja Neni 18, paragrafi 3 i Rregullës Financiare nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se “Shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël”. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t’i aplikojnë.

Ishin bërë keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë prej 399,054€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas vendimit përmbarimor/ të gjykatës për paga, nga kategori investimet kapitale 26,720€, nga kategoria investime kapitale për mallra dhe shërbime 259,554€, nga kategoria mallra dhe shërbime kishte paguar për investimet kapitale 104,241€. Po ashtu nga kategoria investime kapitale komuna kishte paguar 7,018€, që për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime, si dhe nga kategoria mallra dhe shërbime ishin paguar 1,521€, që për nga natyra i takojnë kategorisë për subvencione dhe transfere.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së ndarjeve buxhetore në kategorinë ekonomike adekuate për t’i realizuar pagesat e vendimeve gjyqësore/përmbarimore si dhe planifikimit jo të mirë buxhetor.

Ndikimi Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpien në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) të komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PVF-ve.

Rekomandimi B2 Kryetarja duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Prezantimi jo i saktë i pasurive komunale dhe stoqeve në RVF**Gjetja**

Neni 6 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore paragrafi 3 parasheh se “Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”. Neni 11 përcakton se “Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim. Pasuritë jo financiare kapitale që janë në fazën e investimeve në vijim nuk zhvlerësohen. Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësim”. Po ashtu neni 22 paragrafi 3 i kësaj rregulloreje parasheh se “Të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t’i nënshtrohen normave të zhvlerësimit”.

Vlera e pasurive kapitale të prezantuara në Raportin Vjetor Financiar (RVF) që ishte 24,528,676€, nuk është prezantuar saktë. Kjo për shkak se tri projekte të përfunduara në vlerë prej 440,865€, ndonëse kanë përfunduar, ende nuk janë transferuar në pasuri në përdorim, me ç’rast nuk ka filluar zhvlerësimi i tyre. Këto projekte vazhdojnë të mbahen në regjistra si investime në vijim.

Po ashtu, tri (3) pagesat të bëra për materiale ndërtimore për raste sociale në vlerë prej 275,521€, të cilat datojnë që nga viti 2021, vazhdojnë të mbahen si pasuri investime në vijim, ndonëse kjo pasuri nuk është pronë e komunës. Prandaj, është e domosdoshme që kjo pasuri të largohet nga regjistri i pasurive komunale, pasi nuk plotëson kriteret për t’u klasifikuar si pasuri komunale.

Pasuritë jo-kapitale të prezantuara në RVF (610,307€), nuk janë të sakta, për shkak se Komuna nuk ka aplikuar zhvlerësimin e pasurive në sistemin e e-Pasurisë. Përveç kësaj, pasuritë e blera gjatë vitit 2024, në vlerë prej 19,211€, nuk ishin regjistruar fare në sistemin e e-pasurisë.

Stoqet e prezantuara në RVF në vlerë prej 4,661€ nuk janë të sakta. Auditimit për vitin 2023, kishte evidentuar se një vlerë e konsiderueshme e stoqeve në shumë prej 504,118€, e raportuar nga Komisioni i Inventarizimit, nuk ishte regjistruar në regjistrat e komunës. Kjo vlerë nuk është regjistruar as gjatë vitit 2024, gjë që tregon për mospërmirësim të gjendjes dhe vazhdim të mungesës së kontrollit dhe raportimit jo të duhur të stoqeve. Përveç kësaj dy pagesa të bëra për furnizim me material higjienik në vlerë 24,548€, nuk ishin regjistruar në regjistrin e stoqeve.

Mbajtja jo e saktë e regjistrave të pasurive dhe stoqeve, si dhe mosazhurnimi dhe mosregjistrimi i tyre, ka ndodhur si rezultat i mosangazhimit adekuat të zyrtarëve përgjegjës të pasurisë, për ta menaxhuar pasurinë komunale në përputhje me kërkesat ligjore.

Ndikimi

Mospërditësimi dhe mosregjistrimi i pasurive dhe stoqeve në regjistrat përkatës ndikon në paraqitjen e drejtë dhe të saktë të tyre në RVF, duke kufizuar kështu ofrimin e informatave të plota dhe të sakta.

Rekomandimi B3

Kryetarja duhet shtuar kontrollet për të siguruar që zyrtarët e pasurive bëjnë azhurnimin e regjistrit të pasurive, si dhe regjistrimin e të gjitha pasurive dhe stoqeve të komunës, në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Nënvlërësim i detyrimeve kontingjente

Gjetja

Neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Detyrimet kontingjente (1,224,773€) të prezantuara në nenin 18 në RVF ishin të nënvlerësuar për 15,952€, për faktin se tri* padi ishin prezantuar me vlera më të ulta se sa vlera reale e tyre.

Paraqitja e pasaktë e detyrimeve kontingjente ka rrjedhur si rezultat i mungesës së vëmendjes nga zyrtari përgjegjës për mbajtjen e evidencës së tyre, i cili nuk ka siguruar prezantimin e saktë të detyrimeve kontingjente.

Ndikimi

Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e pasqyrave financiare të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën detyrimeve kontingjente.

Rekomandimi B4

Kryetarja duhet të sigurojë se me rastin e përgatitjes së RVF, detyrimet kontingjente do të vlerësohen dhe paraqiten me vlera të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B5 - Realizimi i sasive të kontratës me çmim për njësi, në mos përputhje me peshën e përcaktuara në dosje të tenderit dhe kontratën

Gjetja

Neni 17 dosja tenderit i Rregullores nr.001/2022 për prokurimin publik, paragrafi 35 parasheh se "Kurdo që Autoriteti Kontraktues (AK) nuk din sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës kategori të shërbimeve në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në baze të poentimit. Si rrjedhojë, peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe rëndësinë e kategorisë përkatëse, që do të thotë se sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë në Dosjen e Tenderit".

Në katër (4) kontrata publike kornizë sipas peshimit me çmim për njësi ishin tejkaluar pesha e përcaktuar gjatë realizimit të kontratës. Rastet janë si në vijim:

Kontrata publike kornizë "Rehabilitimi, mirëmbajtja e infrastrukturës dhe intervenimet e ndryshme në komunën e Graçanicës" e lidhur me 17.05.2023, për periudhë trevjeçare me çmime për njësi, e ndarë në dy lote, vlera e shpenzuar e një kategorie të caktuar, ka tejkaluar vlerën e lejuar për shpenzim sipas peshimit.

Lot 1 "Rehabilitimi i rrugëve lokale dhe urave" me vlerë të parashikuar 1,800,000€, kategoria e parë (1) e paramasës së kontratës "Punimet përgatitore, dheut, zhavorit dhe gjeotekstilit", ishte peshuar me 20% të kontratës apo lejim të shpenzimit deri në vlerë 360,000€, ndërsa realizimi i kësaj kategorie ishte 887,879€, duke tejkaluar vlerën e shpenzimit të lejuar të kategorisë për 527,879€. Po ashtu kategoria e dytë (2) e paramasës së kontratës "Punët e asfaltimit, trotuarit, bravarisë dhe shënjëzimit" ishte peshuar me 30% të kontratës apo lejim të shpenzimit deri në vlerë 540,000€, ndërsa realizimi i kësaj kategorie ishte 865,041€, duke tejkaluar vlerën e shpenzimit të lejuar të kategorisë për 325,041€.

Lot 2 "Rehabilitimi i shtretërve të lumenjve dhe mureve mbrojtëse" me vlerë të parashikuar 1,100,000€, kategoria e parë (1) e paramasës së kontratës "Punimet përgatitore, dheut, zhavorit dhe gjeotekstilit", është peshuar me 20% të kontratës apo lejim të shpenzimit deri në vlerë 220,000€, ndërsa realizimi i kësaj kategorie ishte 341,870€, duke tejkaluar vlerën e shpenzimit të lejuar të kategorisë për 121,870€.

Kontrata publike kornizë me çmim për njësi "Rikonstruktimi, rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në territorin e Komunës së Graçanicës" e lidhur me 21.08.2023, për periudhë trevjeçare në vlerë 600,000€, kategoria e parë (1) "Punët përgatitore dhe të tokës" e peshuar me 20%, është dashtë të realizohet 120,000€, përderisa ishte realizuar 135,366€ me një tejkalim prej 15,366€.

Kontrata publike kornizë me çmim për njësi "Shërbimet për krijimin e dokumentacionit projektues dhe teknik për nevojat e Komunës së Graçanicës" e lidhur me 15.08.2023, për periudhë dyvjeçare në vlerë 120,000€, kategoria e tretë (3) "Hartimi i elaborateve dhe matjeve

gjeodezike” e peshuar me 20%, është dashtë të realizohet 24,000€, përderisa ishte realizuar 96,535€ me një tejkallim prej 72,535€.

Kontrata publike kornizë me çmim për njësi “Furnizimi dhe mbjellja e luleve dhe druve dekorativë për nevojat të komunës” e lidhur me 21.06.2023, për periudhë trevjeçare në vlerë 90,000€, kategoria e dytë (2) “Kurore me lule, buqët dhe ikebane” e peshuar me 30%, është dashtë të realizohet 27,000€, përderisa ishte realizuar 28,703€ me një tejkallim prej 1,703€. Po ashtu kategoria e tretë (3) “Furnizim dhe mbjellja e drunjve dekorativ” e peshuar me 15%, është dashtë të realizohet 13,500€, përderisa ishte realizuar 18,710€ me një tejkallim prej 5,210€.

Vlen të theksohet se pas rekomandimit të dhënë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023, që kontratat publike kornizë me çmim për njësi të zbatohen në pajtueshmëri të plotë me peshimet e përcaktuara, komuna kishte bërë ndërprerjen e tri kontratave pa u realizuar vlerat e tyre të plota. Megjithatë, duhet theksuar se nuk ka qenë e domosdoshme të bëhet ndërprerja e kontratave në tërësi, por vetëm të ndalohet furnizimi apo realizimi i mëtejshëm për ato kategori që kishin arritur apo tejkalluar peshën e lejuar, duke mundësuar kështu realizimin e kategorive të mbetura të kontratës në mënyrë të kontrolluar dhe në përputhje me kontratën. Kjo do të siguronte respektim të peshimeve, pa penguar realizimin e pjesës tjetër të kontratës për kategoritë e papërfunduara.

Këto tejkallime kishin ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të nevojave dhe përcaktimit jo të duhur të peshimit të kategorive në bazë të rëndësisë së punëve/shërbimeve në dosjen e tenderit.

Ndikimi

Tejkallimi i shpenzimit të sasive të lejuara sipas peshës që iu është caktuar në dosjen e tenderit dhe në kontratë, ndikon në mungesë të transparencës në vendimmarrjen për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët. Kjo poashtu, mund të ndikojë në rritjen e shpenzimeve të planifikuara buxhetore.

Ndërprerja e tërësishme e kontratave, për shkak të tejkallimit të peshës vetëm në disa kategori, ka pamundësuar realizimin e pjesës tjetër të kontratës si dhe ka ndikuar drejtpërdrejt në mosrealizimin e objektivave të komunës të parapara me këto kontrata.

Rekomandimi B5

Kryetarja duhet të sigurojë që realizimi i kontratave publike kornizë me çmim për njësi të bëhet në pajtueshmëri të plotë me strukturën e peshimeve të specifikuar në kontratë. Në rast të tejkallimit të peshimeve në kategori të caktuara, duhet të ndalohet furnizimi/realizimi vetëm për ato kategori, duke vazhduar me pjesët tjera të kontratës deri në përmbushjen e plotë të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A1 - Përdorim joadekuat i kontratave publike kornizë për punë me sasi indikative**Gjetja**

Paragrafi 54.2 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh “Kontrata publike kornizë është term i përgjithshëm i marrëveshjeve në mes të autoriteteve kontraktuese si dhe Operatorëve ekonomik për furnizime, shërbime, dhe punë (riparim/ mirëmbajtje), e cila i vendos termat dhe kushtet sipas të cilave kontratat ndihmëse ose bërja e urdhrave mund të kryhet përmes termave të marrëveshjes”. Po ashtu paragrafi 54.10 i kësaj rregullorje parasheh se “Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%)”.

Gjatë vitit 2024, zyra e prokurimit kishte lidhur tri (3) kontrata publike kornizë për punë me sasi indikative për projekte të natyrës ndërtimore. Sipas kërkesave ligjore, kontratat publike kornizë me sasi indikative për punë lejohen vetëm për qëllime të mirëmbajtjes dhe riparimeve, por jo për projekte të ndërtimit.

Kontratat e lidhura ishin për:

- Rikonstruimin dhe asfaltimin e rrugëve lokale, në vlerë prej 1,687,610€;
- Rehabilitimin e shtratit të lumenjve, mureve mbrojtëse, urave dhe kanaleve, në vlerë prej 981,864€;
- Rekonstruimin, sanimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve në Komunën e Graçanicës, në vlerë prej 466,912€.

Të tri kontratat ishin lidhur për një periudhë trevjeçare dhe përfshinin devijim 30% të sasive indikative të kontratës.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mangësive në funksionimin e kontrolleve të brendshme në Zyrën e Prokurimit, të cilat nuk kanë siguruar zbatimin e drejtë dhe të plotë të kërkesave ligjore gjatë inicimit dhe lidhjes së kontratave publike kornizë për punë.

Ndikimi

Përdorimi i kontratave kornizë me sasi indikative për projekte ndërtimore rrezikon planifikimin e saktë buxhetor dhe mund të çojë në shpenzime të paparashikuara për komunën.

Rekomandimi A1

Kryetarja duhet të sigurojë që Zyra e Prokurimit t'i zbatojë në tërësi kërkesat ligjore gjatë inicimit dhe lidhjes së kontratave publike kornizë, duke mos i përdorur këto kontrata pune për projekte të natyrës ndërtimore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës

Gjetja Neni 22 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit, pastaj Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë.

Nga 65 mostrat e testuar si pjesë e testimeve substanciale në investime kapitale kemi vërejt se në 16 raste në vlerë 510,389€, nuk janë respektuar hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht është bërë pranimi i faturës dhe situacionit për punët e kryera e pastaj është lëshuar urdhërblerja.

Kjo ishte si pasojë e dështimit të kontrolleve nga zyra e prokurimit pasi që zyra e prokurimit nuk i kishte respektuar hapat për procedim të pagesave sipas rregullës financiare.

Ndikimi Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave mund të shkakton rritjen e obligimeve komunale ndaj operatorëve ekonomik.

Rekomandimi A2 Kryetarja duhet të sigurojë se zyra e prokurimit do t'i ndjek të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuar me Rregullën Financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A3 - Mungesë e raporteve për vijueshmërinë në punë

Gjetja Neni 17 i Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 evidenca e vijueshmërisë në punë, ndër të tjera parasheh "Zyrtari publik është i obliguar që të regjistrohet në regjistrin elektronik të vijueshmërisë. Vijueshmëria në punë e zyrtarit publik evidentohet përmes regjistrimit në sistemin elektronik që administrohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Kur nuk është e mundur për arsye teknike, vijueshmëria në punë e zyrtarit publik bëhet përmes regjistrimit në librat evidentues". Mungesa e evidentimit të vijueshmërisë në punë nga zyrtari llogaritet si mungesë në punë.

Nga testimi i pagave, kemi identifikuar se për 17 zyrtarë komunal nuk kishte evidenca të vijueshmërisë së rregullt në punë për vitin 2024. Duhet theksuar se prej tyre, 14 janë zyrtarë që janë sistemuar me vendim të përkohshëm në pozita dhe drejtori tjera komunale për dallim nga kontrata e tyre e punës.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mangësive të kontrollit të brendshëm për të mbikëqyrur evidentimin në punë të zyrtarëve përmes raporteve të vijueshmërisë.

Ndikimi Mungesa e raporteve të vijueshmërisë në punë paraqet parregullsi, krijon paqartësi dhe pasiguri nëse zyrtarët komunal kanë pasur vijueshmëri të rregullt në punë si dhe nëse është arsyetuar me punë pagesa e tyre.

Rekomandimi A3 Kryetarja duhet të sigurojë që zyrtarët komunal të evidentohen rregullisht në regjistrin e vijueshmërisë për punë dhe kjo të dëshmohet përmes raporteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mos harmonizimi i kontratave të punës/akt emërimeve sipas kërkesave ligjore

Gjetja Neni 102 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, paragrafi 1 parasheh “ Me hyrje në fuqi të këtij ligji, obligohen të gjitha institucionet që të përgatisin dhe t’ju ofrojnë zyrtareve/ëve aktual për nënshkrim aktet e reja të emërimit dhe/apo kontratat e punës” dhe paragrafi 2 ” Aktet e emërimit dhe/apo kontratat e punës nënshkruhen nga të gjitha palët dhe duhet të jenë në harmoni me përcaktimet e këtij ligji, Ligjit të Punës, si dhe Ligjit për Paga në sektorin publik”.

Neni 16 i Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, paragrafi 2 specifikon “Paga bazë për nëpunësit e shërbimit publik përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit që përket pozita e punës e përcaktuar në shtojcat e këtij ligji”.

Nga testimi i 70 mostrave për pagat e personelit, në 49 prej tyre kemi identifikuar se kontratat e punës/akt emërimet e nëpunësve/zyrtarëve të administratës komunale, arsimit dhe shëndetësisë, nuk ishin përditësuar për të reflektuar nivelin e saktë të pagës bazë - koeficientit. Përkundër faktit se pagat e këtyre nëpunësve/zyrtarëve ishin përlllogaritur sipas ligjit për pagat, megjithatë kjo nuk ishte përcjellur me harmonizim edhe në kontratat e tyre të punës/akt emërimet.

Sipas konfirmimit që kemi pranuar nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, kjo ka ndodhur për shkak se katalogu i vendeve të punës është miratuar nga niveli qendror në fund të vitit 2024 dhe se janë ende në proces të miratimit të rregullores komunale për klasifikimin e vendeve të punës e cila do të pason me harmonizimin e kontratave të punës/akt emërimeve.

Ndikimi Kjo situatë ndikon në mos respektimin e kërkesave ligjore dhe krijon paqartësi, pasi që kontrata e punës/akt emërimi nuk paraqet nivelin e saktë të pagës bazë-koeficientit.

Rekomandimi A4 Kryetarja duhet të sigurojë se kontratat e punës/akt emërimet për nëpunësit/zyrtarët komunal përditësohen dhe harmonizohen sipas kërkesave dhe afateve ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Sistemimi i stafit të sektorit të arsimit dhe shëndetësisë jo në përputhje me kontratat e punës**Gjetja**

Neni 17 paragrafi 1 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212 përcakton “I punësuari caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur Kontratë Pune”. Ndërkaq, paragrafi 2 parasheh

“Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuari në pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës”.

Neni 84 paragrafi 1 i këtij Ligji thekson “I punësuari është i detyruar që në vendin e punës t’iu përmbahet detyrimeve të parapara me ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës”. Poashtu, sipas Strukturës Organizative dhe Rregullores për organizim të brendshëm të Administratës Komunale është i përcaktuar organizimi i brendshëm dhe mënyra e marrjes së akteve të brendshme për sistematizimin e punëve.

Nga 70 mostra të testuara për pagat e personelit, në 30 prej tyre kemi identifikuar se stafi arsimor dhe shëndetësor si: mësimdhënës, administrator, staf teknik mbështetës, infermier dhe bibliotekist, nuk janë sistemuar në vendin e tyre të punës në përputhje me kontratën. Sistemimi i stafit në pozita dhe drejtori të tjera për dallim nga kontrata e punës, ishte bërë përmes vendimeve për sistematizim të përkohshëm me arsyetimin e rritjes së vëllimit të punëve. Sistemimi i stafit ishte bërë pa ndonjë afat të caktuar në drejtorinë e zhvillimit ekonomik, kadastrës, urbanizimit dhe planifikimit hapësinor, bujqësisë dhe pylltarisë, administratës, institucion parashkollor, shtëpinë e të moshuarve, shtëpinë e kulturës dhe kompleksin sportiv në Graçanicë, në pozitat si: zyrtar kryesor i prokurimit, inspektor, arkivist, zyrtar/asistent në administratë dhe kulturë, zyrtar për përgatitjen e projekteve dhe dokumentacionit të projektit. Ndërsa përkundër sistemimit, pagesa e pagave për këta zyrtar ishte bërë sipas kontratës së tyre bazë të punës. Poashtu, për 30 rastet e identifikuara nuk kishte të vendosura objektiva të punës për vitin 2024 dhe rrjedhimisht as raporte të punës, ndërsa vlerësimet e performancës që na janë dërguar për 17 zyrtarë ishin bërë nga drejtoria e arsimit dhe shëndetësisë përkundër sistemimit në drejtori tjera.

Nga listat e stafit që na janë ofruar, në total figurojnë 144 zyrtarë ku prej tyre 110 nga sektori i arsimit dhe 34 nga sektori i shëndetësisë që janë sistemuar në pozita dhe drejtori tjera.

Sipas zyrtarëve përkatës, kjo kishte ndodhur për shkak të numrit të pamjaftueshëm të pozitave të aprovuara të zyrtarëve në departamentet e caktuara të cilët i kanë pamundësuar rekrutimin e punëtorëve të rinj në proporcion me nevojat e komunës.

Ndikimi

Sistemimi i stafit jo në përputhje me pozitën sipas kontratave të punës paraqet shkelje të kërkesave ligjore dhe ndikon në nivel të ulët të përgjegjësisë dhe cilësisë në kryerjen e detyrave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës.

Rekomandimi B6

Kryetarja duhet të sigurojë se stafi arsimor dhe shëndetësor të jetë i angazhuar në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë sipas kontratës së punës. Gjithashtu duhet të krijohet harmonizim në mes të pozitave aktuale dhe atyre të buxhetuara në përputhje me ligjin për ndarje buxhetore i cili i

përgjigjet nevojave të komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Aplikimi i koeficientit jo në pajtueshmëri me ligjin për paga

Gjetja Neni 16 i Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, paragrafi 2 specifikon “Paga bazë për nëpunësit e shërbimit publik përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit që përket pozita e punës e përcaktuar në shtojcat e këtij ligji”.
Neni 102 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, paragrafi 1 parasheh “ Me hyrje në fuqi të këtij ligji, obligohen të gjitha institucionet që të përgatisin dhe t’ju ofrojnë zyrtareve/ëve aktual për nënshkrim aktet e reja të emërimit dhe/apo kontratat e punës” dhe paragrafi 2 ” Aktet e emërimit dhe/apo kontratat e punës nënshkruhen nga të gjitha palët dhe duhet të jenë në harmoni me përcaktimet e këtij ligji, Ligjit të Punës, si dhe Ligjit për Paga në sektorin publik”.

Për një (1) rast kemi identifikuar se nuk ishte aplikuar drejt dhe saktë koeficienti në pagë, sipas shtojcave të ligjit për paga në sektorin publik. Në rastin konkret, për zyrtarin komunal ishte aplikuar koeficienti 4.8 duke e klasifikuar në pozitën e nëpunësit administrativ, përderisa me kontratë të punës zyrtari ishte me pozitë dhe detyra koreograf dhe do duhej të klasifikohej dhe paguhej me koeficient 8 sipas përcaktimit në shtojcën e ligjit për krijuesit dhe performuesit e kulturës dhe artit.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e dobësive të kontrollit të brendshëm për të aplikuar drejtë dhe saktë koeficientin e përcaktuar sipas ligjit për paga si dhe për të reflektuar kërkesat ligjore edhe në kontratën e punës.

Ndikimi Kjo situatë shkakton mos respektim të kërkesave ligjore, trajtim jo të barabartë dhe dëmtim financiar në pagën e zyrtarit komunal.

Rekomandimi A5 Kryetarja duhet të sigurojë se zyrtarit komunal i aplikohet koeficienti i drejt në pagë sipas përcaktimit ligjor. Poashtu, në formë retroaktive zyrtarit t’i kompensohet diferenca e pagës për të cilën nuk është paguar sipas kërkesave ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë

Gjetja Neni 12 i Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, përcakton se komuna ka përgjegjësi për regjistrim dhe menaxhim të të dhënave të tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë ashtu siç përcaktohet në aktin nënligjor.
Neni 7 i Udhëzimit Administrativ Nr.03/2011 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin , paragrafi 1.1 specifikon “ Të dhënat për tatimpaguesin përfshijnë numrin personal identifikues (tatimpaguesit fizik)”.

Gjatë analizës së bazës së të dhënave të tatimit në pronë është identifikuar se 423 tatimpagues individual nuk kanë të prezantuar numrat personal në këtë bazë. Duhet theksuar se komuna në vitet paraprake përmes ueb faqes

zyrtare të saj kishte bërë thirrje për tatimpaguesit që të përditësojnë të dhënat e tyre në shërbimin tatimor, mirëpo jo edhe gjatë vitit 2024.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e dobësive të kontrollit të brendshëm për azhurnim të informatave për tatimpaguesit në bazën e të dhënave për tatimin në pronë.

Ndikimi Mungesa e të dhënave në data bazë për numrat identifikues personal të tatimpaguesve paraqet mangësi dhe potencialisht mund të ndikojë në përfitim të paligjshëm të disa hershëm të tatimpaguesve, të zbritjes së lejuar për vendbanim parësor.

Rekomandimi A6 Kryetarja duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve. Përditësimi i të dhënave në Protax të bëhet në baza të rregullta periodike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A7 - Mungesë e dëshmive për llogaritë e arkëtueshme nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë

Gjetja Rregulla financiare 03/2010 për të hyrat, përcakton kërkesat dhe procedurat për regjistrimin, barazimin dhe mbledhjen e të hyrave vetanake. Neni 8 paragrafi 5 i kësaj rregulle specifikon "OB-të për shërbimet e ofruara duhet të lëshojnë faturë me numër referent i cili numër llogaritet sipas udhëzimeve teknike të cekura në Nenin 3 të Udhëzimit Administrativ 2007/06.

Për 12 mostra të testuara për llogaritë e arkëtueshme nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë në vlerë 24,300€, komuna nuk posedon dëshmi burimore si faturë apo ndonjë dokument tjetër që konfirmon shumën e borxhit të prezantuar në RFV. Duhet theksuar se vlera gjithsej e këtyre llogarive të raportuara për vitin 2024 është 666,460€.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e dobësive të kontrollit të brendshëm. Poashtu, sipas konfirmimit të drejtorisë përkatëse komunale që menaxhon këto llogari, kjo drejtori nuk lëshon ndonjë dokument për këto llogari dhe se faturat lëshohen vetëm në rast të kërkesave të subjekteve afariste dhe se mbledhja e taksës bëhet vetëm në bazë të urdhëresës komunale.

Ndikimi Mungesa e dëshmive për borxhet që pret komuna t'i arkëtojë dhe të cilat janë raportuar në RFV, krijon mangësi dhe situatë kontestuese për mundësitë e mbledhjes së borxhit dhe saktësisë.

Rekomandimi A7 Kryetarja duhet të sigurojë se për llogaritë e arkëtueshme të raportuara në RFV, komuna posedon dëshmi burimore që konfirmon shumën e borxhit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Vonesa në pagesën e detyrimeve të papaguara në PVF

- Gjetja** Neni 39.1 i Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore".
- Nga tri (3) rastet e testuar të faturave nga raporti i obligimeve të papaguara në shumë totale prej 14,300€, kemi vonesa në pagim të obligimeve. Vonesat tejkalojnë periudhën prej 30 ditësh nga periudha e përcaktuar ligjore. Obligimi prej 2,985€, nuk ishte paguar ende.
- Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.
- Ndikimi** Vonesat në kryerjen e obligimeve mund t'i shkaktojnë kosto shtesë komunës për shkak se ajo mund të përballet me padi ku përveç vlerës së faturës duhet t'i paguaj kostot shtesë përfshirë kamatën, interesin dhe shpenzimet gjyqësore.
- Rekomandimi A8** Kryetari duhet të siguroj se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, si dhe obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave në mënyrë që të shmangen pagesat shtesë të interesit nga vendimet gjyqësore/përmbarimore.
- Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 2,917,998€, prej tyre ishin shpenzuar 2,443,410€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale, ndërtimin e kanalizimeve, ndërtimin e objekteve arsimore dhe shëndetësore, rregullimin e parqeve.

Çështja A9 - Menaxhimi i kontratave jo përmes platformës së prokurimit

Gjetja Neni 70 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik paragrafi 10 parasheh se “Pas pranimit të njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i kontratës duhet të kyçet në sistem të prokurimit elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës”.

Menaxherët e kontratave/projekteve për vitin 2024, nuk e kanë mbajtur menaxhimin e kontratave përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Kjo ka ndodh si rezultat i dështimeve të menaxherëve të kontratave për t'i menaxhuar kontratat përmes sistemit të prokurimit.

Ndikimi Mosmenaxhimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo efektiv të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi A9 Kryetarja duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të bëhet përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A10 - Mosrespektimi i afatit ligjor për pranimin e tenderëve

Gjetja Neni 44 i Ligjit të Prokurimit Publik ndër të tjera parasheh se “Gjatë një prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve. Kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se dyzet (40) ditë”. Po ashtu neni 46 i këtij ligji ndër të tjera parasheh se “ Nëse ekzistojnë rrethanat që: (i) kërkojnë zbatimin e një aktiviteti të prokurimit në raste urgjente; (ii) e bëjnë të pamundur respektimin e afateve kohore të përcaktuara në nenin 44 të këtij ligji ose nëse është e aplikueshme edhe në nenin 45 të këtij ligji; (iii) nuk shkaktajnë urgjencat e parashikuara nga neni 35.2.1, autoriteti kontraktues mundet të zbatojë prokurimin me përdorimin e afateve të përshpejtuara kohore që përcaktohen me këtë nen”.

Zyra e prokurimit tek dy aktivitetet e prokurimit me procedurë të hapur për kontrata me vlera të mëdha nuk kishte respektuar kërkesën ligjore në lidhje me afatin prej 40 ditëve për pranimin e tenderëve. Afati që ishte përcaktuar për pranimin e tenderëve ishte 15 ditë, pra nga data 05.11-20.11.2024. Në dosjen e prokurimit, ne nuk kemi vërejtur se kishte ndonjë arsye relevante

që ka shtyrë komunën në mosrespektimin e afatit ligjor. Këto kanë të bëjë me kontratat publike kornizë "Rikonstruimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale", në vlerë prej 1,687,610€ dhe kontratën "Rehabilitimi i shtratit të lumenjve, mureve mbrojtëse, urave dhe kanaleve", në vlerë prej 981,864€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të pamjaftueshme brenda Zyrës së Prokurimit për të siguruar respektimin e kërkesës ligjore lidhur me afatin për pranimin e ofertave/tenderëve.

Ndikimi

Mosrespektimi i afateve ligjore për pranimin e tenderëve për aktivitetet e prokurimit me procedurë të hapur për kontrata me vlera të mëdha, pa ndonjë arsye të dokumentuar, mund të ndikoj në kufizimin e konkurrencës duke ulur mundësitë për pjesëmarrje të barabartë të operatorëve ekonomikë të interesuar, si dhe të pamundësojë përgatitjen dhe dorëzimin me kohë dhe në mënyrë të plotë të ofertave.

Rekomandimi A10

Kryetarja duhet të forcojë dhe shtojë kontrollet për të siguruar që Zyra e Prokurimit të respektojë plotësisht afatet ligjore të përcaktuara për pranimin e tenderëve, me qëllim garantimin e një procesi të drejtë dhe konkurrues në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 24,528,676€, pasurive jokatitale është 610,307€, si dhe e stoqeve 4,661€.

Çështja A11 - Mungesa e realizimit të inventarizimit të pasurisë jofinanciare

Gjetja

Neni 18 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore nder të tjerash parasheh se “Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Organizatat buxhetore duhet të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiare”.

Kryetarja e Komunës, me vendim të datës 11.09.2024, kishte caktuar komisionin për inventarizimin e pasurive komunale jofinanciare. Megjithatë, ky komision nuk e ka kryer punën për të cilën ishte emëruar, pasi nuk e kishte bërë inventarizimin e pasurive komunale për vitin 2024.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrollit të duhur nga ana e menaxhmentit për të mbikëqyrur dhe mbajtur përgjegjës komisionin që të përmbushë detyrat sipas kërkesave ligjore, si dhe për shkak të dështimit të vetë komisionit për të kryer detyrën për të cilën është caktuar.

Ndikimi

Mungesa e inventarizimit të pasurive komunale jofinanciare rrit rrezikun për një prezantim të pasaktë dhe jo të drejtë të tyre në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A11

Kryetarja të ndërmarrë masa për forcimin e kontrolleve të brendshme, me qëllim që të sigurohet se komisioni i inventarizimit të pasurive jofinanciare realizon inventarizimin në përputhje me dispozitat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna e Graçanicës në RFV e vitit 2024 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë totale prej 5,648,459€. Kjo vlerë përbëhet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë në vlerë 4,263,440€, të arkëtueshmet nga qiratë në vlerë 17,621€, të arkëtueshmet nga shpronësimi i tokës komunale në vlerë 671,855€, të arkëtueshmet nga taksa për veprimtari në vlerë 666,460€ si dhe llogaritë për gjobat nga inspeksioni 29,083€. Krahasuar me vitin paraprak, llogaritë e arkëtueshme për vitin 2024 janë rritur në vlerë 660,542€ apo 13.24%.

Çështja B7 - Mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Neni 26 i Ligjit Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, përcakton se “Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove”. Ligji Nr. 08/L-244 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.06/L-055 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 6 specifikon se për vitin tatimor 2024 dhe vitet tatimore pasuese, detyrimi tatimor për personat jo-rezidentë mund të paguhet në një kësht të vetëm, më së largu në datën 30 shtator të vitit tatimor përkatës. Rregulla financiare 03/2010 për të hyrat, përcakton kërkesat dhe procedurat për regjistrimin, barazimin dhe mbledhjen e të hyrave vetanake.

Llogaritë e arkëtueshme për vitin 2024 janë raportuar në vlerë 5,648,459€, prej të cilave 4,263,440€ apo 75% ishin për tatimin në pronë. Krahasuar me vitin paraprak, llogaritë për tatimin në pronë janë rritur për 436,237€ apo 11%. Përkundër se komuna kishte paralajmëruar tatimpaguesit për vonesat e tyre në pagesë, nuk kishte pasur rezultat në mbledhjen e këtyre borxheve si dhe nuk kishte ndërmarrë veprime të mëtejshme ligjore për arkëtim.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve të mjaftueshme dhe vazhdueshme të departamenteve përgjegjëse në tentim të mbledhjes së borxheve, poashtu mungesës së strategjisë për inkasim.

Ndikimi

Mos realizimi i të hyrave të planifikuara, rritë rrezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetanake. Vjetërsia e të arkëtueshmeve e vështirëson apo edhe pamundëson mbledhjen e tyre.

Rekomandimi B7

Kryetarja duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre. Poashtu të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve si dhe të krijojë strategji të mbledhjes së tyre, përfshirë dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore për inkasim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^e	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	8,985,460	9,893,412	9,323,960	9,318,337	7,841,438
Grante Qeveritare - Buxheti	6,695,382	6,397,983	6,395,178	6,698,911	5,105,187
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	185,787
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	0	0	0	0	234,740
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,099,885	1,064,284	655,381	845,048
Të hyrat vetanake	2,290,078	2,388,258	1,857,532	1,964,046	1,470,676
Donacionet e jashtme	0	7,285	6,966	0	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 907,952€. Kjo rritje ishte nga të hyrat vetjake të bartura nga vitet paraprake 1,099,885€, rritje nga të hyrat vetjake të mbledhura në vitin 2024 për 98,180€, rritje nga donacioneve prej 7,285€ si dhe zvogëlim i buxhetit nga granditë e Qeverisë prej 297,398€.

Komuna ka shpenzuar rreth 94% të buxhetit final e cila paraqet një performancë të mirë buxhetore.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	8,985,460	9,893,412	9,323,960	9,318,337	7,841,438
Pagat dhe mëditjet	4,284,720	3,987,321	3,987,321	3,713,663	3,155,251
Mallrat dhe shërbimet	1,796,268	1,998,804	1,964,523	1,866,939	1,962,539
Komunalitë	211,000	299,713	264,851	226,781	200,530
Subvencionet dhe transferet	380,859	689,575	663,854	425,150	246,031
Investimet Kapitale	2,312,613	2,917,998	2,443,410	3,085,803	2,277,088

Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomik janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje me vendim të qeverisë ishte zvogëluar për 297,399€, krahasuar me buxhetin fillestar.


Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 202,536€. Kjo rritje vjen si rritje nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023. Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash kanë të bëjë me pagesat e bëra për furnizime, pasje të teknologjisë informative, mirëmbajtje dhe servisim, pastrim të objekteve. Thesari nga kjo kategori sipas vendimeve përmbarimore/gjyqësore kishte paguar 104,241€, për shpronësim që për nga natyra i takojnë kategorisë investime kapitale.

Buxheti final për komunalitet është rritur për 88,713€, nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023.

Buxheti final për subvencione ishte rritur për 308,716€. Kjo rritje vjen si rritje nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023 në vlerë 210,536€, si dhe rritje nga të hyrat vetjake të viti 2024 për 98,180€. Shpenzimet kanë të bëjë me pagesat e bëra për përkrahjen e OJQ-ve, të individëve si dhe për përkrahjen e qytetarëve që janë me raste sociale.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 605,385€. Kjo rritje vjen si rezultat i bartjes së të hyrave vetjake të pa shpenzuar nga vitin 2023 për 598,100€, rritje nga donacionet për 7,285€. Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash kanë të bëjë me pagesat e bëra për projektet kapitale si për ndërtimin e rrugëve lokale, rregullimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtimin e objekteve, fushave sportive. Vlen të ceket se thesari nga kjo kategori sipas vendimeve përmbarimore/gjyqësore kishte paguar 26,721€, për paga, si dhe për mallra dhe shërbime 259,554€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara në vitin 2024 ishin në vlerë 2,515,547€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna për vitin 2024, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 379,340€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	2,290,078	2,290,078	2,515,547	2,654,690	1,944,896
Të hyrat tatimore	1,346,966	1,346,966	1,244,362	1,140,949	978,808
Të hyrat jo tatimore	943,112	943,112	1,270,917	1,513,740	966,087
Të hyrat tjera	0	0	268		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023, kishte rezultuar me 12 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit i vitit 2023 ishte diskutuar në Asamblenë Komunale. Deri në fund të auditimit tonë, pesë (5) rekomandime ishin zbatuar dhe shtatë (7) rekomandime nuk ishin zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetarja duhet të sigurojë kontrolle efektive në regjistrimin, kontrollimin dhe paraqitjen e saktë të vlerës së detyrimeve të papaguara, sipas kërkesës së rregullore për raportim financiar, në mënyrë që të mundësohet raportim i saktë i tyre në PVF.	Nuk kemi has çështje të kësaj natyre për 2024.	I zbatuar
2.	Baza për opinion	Kryetarja duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen sipas kategorive ekonomike adekuate, në përputhje me planin kontabël, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF.	Edh vitin 2024 kishte keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për konkluzion	Kryetarja e Komunës duhet të sigurojë përmes njësisive kërkuese dhe departamentit të prokurimit, që gjatë përgatitjes së kërkesave dhe dosjeve të tenderit për kontratat publike kornizë sipas peshimit, të luaj një rol aktiv në përcaktimin e nevojave reale të komunës, në mënyrë që këto kontrata të realizohen në pajtueshmëri të plotë me peshët e përcaktuara në dosjen e tenderit.	Edhe në vitin 2024 kishte tejkalime të kategorisë sipas peshimit	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Baza për konkluzion	Kryetarja duhet të sigurojë se të gjithë stafi arsimor të jetë i angazhuar në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë sipas kontratës së punës. Gjithashtu duhet të krijohet një harmonizim në mes të pozitave aktuale dhe atyre të buxhetuara në përputhje me ligjin për ndarje buxhetore i cili i përgjigjet nevojave të komunës.	Raste të ngjashme janë identifikuar edhe gjatë vitit 2024.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Të hyrat	Kryetarja duhet të sigurojë mbikëqyrjen dhe verifikimin e marrëveshjeve për shfrytëzimin e objekteve komunale afariste, për të siguruar se zbritja për qiramarrësit aplikohet në përputhje me dëshmitë e kërkuara sipas rregullores përkatëse.	Nuk kemi hasur në raste të tilla për vitin 2024.	I zbatuar
6.	Investimet kapitale	Kryetarja duhet të sigurojë forcimin e kontroleve në vlerësimin e ofertave me çmime jo normalisht të ulëta, duke kërkuar dhe siguruar shpjegime të detajuara mbi bazën e çmimeve të ulëta, sikurse analizën e kostove, burimet e materialeve, si dhe duke kërkuar rritjen e sigurisë së ekzekutimit të kontratës. Poashtu të sigurojë kryerjen e inspektimeve të rregullta lidhur me realizimin e cilësisë dhe sasisë së kontratës në fjalë.	Nga mostrat tona nuk kemi hasur gjetje të kësaj natyre.	I zbatuar
7.	Pasuritë	Kryetarja duhet të sigurojë se pasuritë kapitale, jokapitale dhe stoqet regjistrohen në kategorinë dhe vlerën e saktë të tyre, në mënyrë që prezantimi i tyre në PVF të jetë i plotë dhe i saktë.	Nuk janë marrë veprime pasi raporti i pasurive dhe stoqeve nuk ishte paraqitur në mënyrë të saktë.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetarja duhet të sigurojë forcimin e kontroleve të brendshme, në mënyrë që të përmirësohet procesi i menaxhimit dhe prezantimit të drejtë të llogarive të arkëtueshme në PVF.	Edhe për vitin 2024 vazhdon gjendja e njëjtë pasi ka nënvlerësim të llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatimin

9.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetarja duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.	Situatë e njejtë ka vazhduar edhe për vitin 2024 pasi që janë identifikuar mangësi lidhur me menaxhimin e llogarive të arkëtueshme në drejtim të inkasimit.	Nuk ka filluar zbatim
10.	Detyrimet Kontingjente	Kryetarja duhet të sigurojë se me rastin e përgatitjes së PVF, detyrimet kontingjente do të vlerësohen dhe paraqiten me vlera të sakta.	Nuk janë marrë veprime pasi raporti i detyrimeve kontingjente ishte i nënvlersuar.	Nuk ka filluar zbatim
11.	Auditimi i Brendshëm	Kryetarja duhet të sigurojë se drejtoritë e audituara përgatisin planet e veprimit për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga NjAB, dhe ndërmarrin veprime konkrete për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të brendshëm.	Janë bashkëngjitur planet e adresimit të rekomandimeve.	I zbatuar
12.	Auditimi i Brendshëm	Kryetarja duhet të sigurojë marrjen e veprimeve për themelimin e Komitetit të Auditimit sipas kërkesave ligjore.	Është themeluar komiteti i auditimit.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Florim Beqiri, Udhëheqës i ekipit



Mexhit Ferati, Anëtar i ekipit



Jetmira Isufi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Realizimi i sasive të kontratës me çmim për njësi, në mos përputhje me peshën e përcaktuara në dosje të tenderit dhe kontratën	<p>Të gjitha kontratat që Zyra e Prokurimit i ka lidhur mbi bazën e peshimit, janë nënshkruar para se të publikohej Sqarimi i KRPP-së numër 28. Pas rekomandimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, ua kemi dërguar të gjitha Njësive Kërkuese dhe menaxherëve të projekteve një udhëzim që sasia e artikujve të peshuar duhet të bëhet mbi bazën e peshimit dhe rëndësisë së kategorisë përkatëse, që do të thotë se sasia e realizuar (e konsumuar) nuk mund dhe nuk duhet të jetë ndryshe nga raporti i peshës i dhënë në Dosjen e Tenderit.</p> <p>Duke pasur parasysh që disa sasi tashmë ishin tejkualuar, kemi pranuar kërkesa nga Njësiti Kërkuese dhe menaxherët e projekteve që ato kontrata të ndërpriten, pasi nuk është e mundur që ato të zbatohen pa artikujt që janë tejkualuar.</p> <p>Zyra e Prokurimit nuk i ka ndërprerë kontratat me çmime individuale dhe të bazuara në peshim me vetiniciativë, por mbi bazën e këtyre kërkesave.</p>	<p>Zyra e Prokurimit është dashur që Interpretimin nr. 28 të KRPP-së, të datës 09.06.2023, ta shpërndajë dhe komunikojë me kohë tek njësitë kërkuese dhe menaxherët e kontratave, në mënyrë që zbatimi i kontratave të bëhet në përputhje të plotë me përmbajtjen e këtij interpretimi si dhe me dispozitat kontraktuale.</p> <p>Për më tepër, në raportin e auditimit për vitin 2023 është rekomanduar që kontratat publike kornizë me çmime për njësi të zbatohen në përputhje të plotë me peshimet e përcaktuara në dosjen e tenderit. Prandaj, konsiderojmë se Komuna nuk ka pasur nevojë të ndërpresë kontratat në tërësi, por është dashur të ndalojë vetëm realizimin për ato kategori ku është tejkualuar sasia e peshuar, duke vazhduar me realizimin e kategorive të tjera në përputhje me peshët e kontraktuara, deri në përmbushjen e kontratës. Kjo qasje do të siguronte zbatim të drejtë dhe të balancuar të kontratës, në përputhje me qëllimin dhe parimet e menaxhimit të kontratave.</p> <p>Gjetja dhe rekomandimi i dhënë mbeten të pandryshuar.</p>

<p>Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës</p>	<p>Zyra e Prokurimit nuk është kompetente për porositjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve, po ashtu as për pranimin e faturave dhe zotimin e mjeteve.</p> <p>Menaxherët e projekteve dhe të Njësisë Kërkuese nuk e informojnë Zyrën e Prokurimit për porositë e mallrave, shërbimeve dhe punëve, por vetëm pas pranimit të faturës dhe situacioneve për punët e kryera, pranimit të mallrave apo shërbimeve, na dërgojnë rezervimin (zotimin) e mjeteve dhe vetëm atëherë Zyra e Prokurimit mund ta bëjë urdhrin për pagesë.</p> <p>Zyra e Prokurimit do të njoftojë të gjithë menaxherët e projekteve dhe Njësitë Kërkuese që të ndjekin hapat për porositjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve sipas rregullave.</p>	<p>Zyra e Prokurimit është e obliguar të respektojë hapat e përcaktuar në nenin 22 të Rregullores Financiare Nr. 01/2013, duke siguruar që urdhërblerja të lëshohet përpara se të kryhet shërbimi/puna dhe të pranohet fatura.</p> <p>Në raportin e auditimit nuk është konstatuar si gjetje se Zyra e Prokurimit është kompetente për porositjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve apo për pranimin e faturave. Megjithatë, është theksuar se nuk janë respektuar hapat e parapara për procedimin e pagesave, pasi urdhërblerja është lëshuar vetëm pas pranimit të faturës dhe situacionit për punët e kryera, gjë që bie ndesh me kërkesat e rregullores në fuqi.</p> <p>Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuar.</p>
<p>Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë</p>	<p>Tatimpaguesit që nuk kanë numër personal në sistemin PROTAX, humbin të drejtën për zbritje për vendbanim parësor, andaj është në interesin e tatimpaguesve që të përditësojnë të dhënat e tyre personale.</p>	<p>Komuna ka bërë vetëm një përshkrim, pa prezantuar ndonjë dëshmi mbështetëse që do të ndikonte në ndryshimin e gjetjes sonë.</p> <p>Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuar.</p>

<p>Mosrespektimi i afatit ligjor për pranimin e tenderëve</p>	<p>Zyra e Prokurimit vlerëson se të gjitha procedurat, përfshirë edhe shkurtimin e afateve, i ka kryer në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe sipas neneve që i keni përmendur edhe ju.</p> <p>Neni 46 i këtij ligji, ndër të tjera, parasheh që “Nëse ekzistojnë rrethana që: (i) kërkojnë zhvillimin e aktivitetit të prokurimit publik në bazë urgjente, (ii) e bëjnë të pamundur respektimin e afateve të përcaktuara në nenin 44 të këtij ligji, ose nëse është e zbatueshme edhe në nenin 45 të këtij ligji; (iii) nuk shkaktojnë urgjencën e parashikuar në nenin 35.2.1, autoriteti kontraktues mund të zhvillojë prokurimin duke përdorur afate të përshpejtuara që përcaktohen me këtë nen.”</p> <p>Arsyet e dhëna nga Njësia Kërkuese janë publikuar në Njoftimin për kontratë B05 si dhe në Dokumentin e Tenderit.</p> <p>Departamenti për monitorim i KRPP-së nuk ka pasur vërejtje gjatë shqyrtimit të procedurave të shpallura.</p>	<p>Komuna nuk ka ofruar asnjë dëshmi të mjaftueshme që do të arsyetonin largimin e gjetjes së auditimit.</p> <p>Në pikën IV.3.3 të letrës B05 të Njoftimit për Kontratën keni shkruar fjalinë: “Kontrata e mëparshme për këtë lloj procedure është ndërprerë në bazë të Interpretimit të KRPP-së nr. 28 dhe draft raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2023 me nr. A3. Për të vazhduar sa më shpejt me këto punime jemi të detyruar të shpallim procedurë të përshpejtuar.”</p> <p>Megjithatë, as Interpretimi nr. 28 i KRPP-së, e as draft raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2023 nuk kanë kërkuar ndërprerjen e kontratës publike kornizë me çmim për njësi sipas peshës, mirëpo respektimin e peshës së përcaktuar gjatë zbatimit të kontratës, dhe jo ndërprerjen e saj.</p> <p>Për rrjedhojë, fjalia e vendosur nga ju në dokumentin B05 nuk përbën ndonjë arsye të vlefshme, rrethanë të jashtëzakonshme apo urgjente që do të arsyetonte përdorimin e procedurës së përshpejtuar dhe shkurtimin e afateve ligjore për pranimin e tenderëve.</p> <p>E gjetura dhe rekomandimi mbeten të pandryshuar.</p>
---	--	---

REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE / DATUM: 13-06-2025			
Nr. Prot. Br. Prot. Prof. No.	Nr. Prot. Br. Prot. Prof. No.	Nr. Prot. Br. Prot. Prof. No.	Nr. Prot. Br. Prot. Prof. No.
04	47	961	3



REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА KOMUNA E GRAÇANICËS MUNICIPALITY OF GRAÇANICA
Op. Nr. 2457/2572-06-2025

ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
 KOMUNA E GRAÇANICËS
 MUNICIPALITY OF GRAÇANICA

POTVRDNO PISMO

O saglasnosti sa nalazima Generalnog Revizora na Izveštaju revizije za 2024 godinu kao i za sprovođenje preporuka

Za: Nacionalnu Kancelariju Revizije:

Poštovani,

Preko ovog psima, potvrđujem da:

- sam primio nacrt izveštaja Nacionalne Kancelarije Revizije o Reviziji Finansijskih Izveštaja Opštine Gračanica, za godinu završno sa 31 decembrom 2024. (u daljem tekstu "Izveštaj");
- Delimično se slažem sa nalazima i preporukama i u nastavku dostavljam komentare u vezi sa sadržajem nacrt izveštaja dobijenih od strane nadležnih odeljenja - službi i dostavljam komentare kao u nastavku:

Pitanje	Komentari BO-a
Pitanje B5 - Realizacija ugovornih količina sa cenom po jedinici, koja nije u skladu sa ponderisanjem koje je utvrđeno u tenderskom dosijeu i ugovoru	Svi ugovori koje je Kancelarija za nabavke sklopila na osnovu ponderisanja, bili su potpisani pre nego što je objavljeno Tumačenje RKJN broj 28. Posle preporuke Nacionalne Kancelarije Revizije, poslali smo svim Jedinicama za zahtevanje kao i menadžerima projekata uputstvo da količine ponderisanje artikala treba vršiti na osnovu ponderisanja i važnosti relevantne kategorije, što znači da realizovana (potrošena) količina ne može i ne bi trebalo da se razlikuje od odnosa težine datih u Tenderskom dosijeu. Sa obzirom da su neke količine već bile prekoračene, dobili smo zahteve od Jedinica za zahtevanje i menadžera projekata da se ti ugovori raskinu jer nije moguće da se ovi ugovori implementiraju bez artikala koji su prekoračeni.

	Kancelarija za nabavke nije samoinicijativno raskinula ugovore sa pojedinačnim cenama i na osnovu ponderisanja, već na osnovu ovih zahteva.
Pitanje A2 - Nepoštovanje koraka za obradu plaćanja u skladu sa zahtevima Pravila	<p>Kancelarija za nabavke nije nadležna za naručivanje roba, usluga i radova kao ni za prijem faktura i rezervaciju sredstava.</p> <p>Menadžeri projekata i Jedinice za zahtevanje ne obavestavaju Kancelariju za nabavke o porudžbinama</p> <p>roba, usluga i radova, već nam se nakon izvršenog prijema fakture i situacije za izvedene radove, prijem robe ili usluga, dostavljaju rezervaciju sredstava i eka tada Kancelarija za nabavke može da uradi nalog za plaćanje.</p> <p>Kancelarija za nabavke će obavestiti sve</p> <p>Menadžere projekata i Jedinice za zahtevanje da prate korake za naručivanje roba, usluga i radova prema Pravilima.</p>
Pitanje A10 - Nepoštovanje zakonskog roka za prihvatanje tendera	<p>Kancelarija za nabavke smatra da je je sve procedure kao i skraćivanje rokova uradila u skladu sa Zakonom o Javnim Nabavkama i prema članovima koje ste i Vi naveli.</p> <p>Član 46. ovog zakona između ostalog, predviđa da "Ako postoje okolnosti koje: (i) zahtevaju sprovođenje aktivnosti javne nabavke po hitnoj osnovi, (ii) čine nemogućim poštovanje utvrđenih vremenskih rokova u članu 44. ovog zakona ili ako je primenljivo i u članu 45. ovog zakona; (iii) ne prouzrokuju hitnosti predviđene iz člana 35.2.1, autoritet za ugovaranje može sprovesti nabavku upotrebom ubrzanih vremenskih rokova koji se utvrđuju ovim članom".</p> <p>Razlozi koje je navela Jedinica za zahtevanje objavljeni su u B05 Obaveštenju za ugovor kao i u Tenderskom Dokumentu.</p> <p>Odeljenje za monitoring RKJN nije imalo primedbe prilikom pregleda raspisanih procedura.</p>
Pitanje A6 - Nedostaci u bazi podataka poreskih obveznika za porez na imovinu	Poreski obveznici koji u sistemu PROTAX nemaju lični broj, gube parvo na odbitak za primarno boravište, tako da je u interesu poreskih obveznika da ažuriraju svoje lične podatke.

<p>Pitanje A6 - Nedostaci u bazi podataka poreskih obveznika za porez na imovinu.</p>	<p>Poreski obveznici koji u sistemu PROTAX nemaju lični broj, gube parvo na odfitak za primarno boravište, tako da je u interesu poreskih obveznika da ažuriraju svoje lične podatke.</p>
---	---

- u roku od 30 dana od prijema Završnog izveštaja, dostaviti akcioni plan za sprovođenje preporuka, koji će uključiti vremenske rokove i osoblje koje je odgovorno za njihovo sprovođenje.

Prof. dr Ljiljana Šubarić

Predsednica Opštine Gračanica

Datum: 12.06.2025, Gračanica



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Padia IV. EK. Br. 156/2018 është prezantuar 930,430.78€, është dashtë të prezantohet 937,075.87€. Padia IV. EK. Br. 519/16 është prezantuar 29,128€, është dashtë të prezantohet 30,899€. Padia II. EK. Br. 591/16 është prezantuar 2,833.22€, është dashtë të prezantohet 10,370€.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.